



LIDA Stories

lidastories.net

**Tingujt e zogjve në mëngjes / O
som dos passaros pela manhã**

LIDA Portugal

Vilius Aistis Vilimas

Maria Hila (sq), Elsa Teixeira (pt)



This work is licensed under a Creative Commons
[Attribution 4.0 International License](https://creativecommons.org/licenses/by/4.0).
<https://creativecommons.org/licenses/by/4.0>



**Tingujt e zogjve në mëngjes
O som dos passaros pela
manhã**

LIDA Portugal

Vilius Aistis Vilimas

Maria Hila

5

Shqip / português



Yulia, bashkëshorti i saj dhe vajza e tyre e vogël jetonin në një fshat të vogël dhe të qetë në Ukrainë. Yulia e adhuronte të zgjohej çdo mëngjes nga tingujt e zogjve. Ajo nuk e kishte menduar kurrë se do të jetonte larg shtëpisë, ose që nuk do të zgjohej nga tingujt e zogjve në mëngjes.

...

Yulia, o seu marido e a sua filha pequena viviam numa pequena e tranquila aldeia na Ucrânia. Yulia adorava ser acordada todas as manhãs pelo som dos pássaros. Ela nunca pensou em viver longe de casa ou não acordar ao som dos pássaros pela manhã.



Bashkëshorti i saj ankohej gjithmonë se nuk
kishin mjaftueshëm para dhe nisi të pinte
shumë. Ata vendosën të provonin fatin e tyre në
Portugali. Ndoshata aty mund të fitonin më
shumë para për të ndërtuar një shtëpi dhe për
të pasur një të ardhme më të mirë për familjen e
tyre.

...

O marido estava sempre a queixar-se de ter
pouco dinheiro e começou a beber muito.
Decidiram tentar a sua sorte em Portugal. Talvez
lá pudessem ganhar mais dinheiro para
construir uma casa e um futuro melhor para a
sua família.



Yulia u përshtat mirë me shtëpinë e re, dhe filloi të punonte si pastruese. Klientët e saj e vlerësonin shumë punën e saj të fortë dhe se sa e sjellshme ishte. Bashkëshorti i saj, nga ana tjetër, ndihej gjithmonë e më shumë i papërfshirë. Për shkak të problemit të tij me pijen, punëdhënësit nuk e besonin dhe nuk i jepnin punë.

...

Yulia adaptou-se bem à sua nova casa e começou a trabalhar como empregada de limpeza. Os seus clientes apreciaram muito o seu trabalho árduo e a sua atitude educada. O seu marido, por outro lado, sentiu-se cada vez mais excluído. Devido ao seu problema com a bebida, os patrões não confiavam nele e não lhe davam trabalho.



Yulia shkoi në një qendër për gratë, ku u ndje
më e sigurt seç ishte ndjerë në një kohë të gjatë.
Nuk ishte ndjerë ashtu qëkur zgjohet nga tingujt
e zogjve në mëngjes.

...

Yulia foi para um abrigo para mulheres onde se
sentiu segura, como há muito não se sentia. Ela
não se sentia assim desde o tempo em que era
acordada pelo ao dos pássaros pela manhã.



Një ditë ai nisi t'i bërtiste Yulias. Më pas, nisi ta
shqynte. Të bërtiturat dhe të rrahurat u
përkeqësuan, veçanërisht kur ishte i dehur. Yulia
ishite e frikësuar për veten dhe për vajzën e saj,
por ajo nuk dinte se çfarë mund të bënte.

...

Um dia, começou a gritar com Yulia. Depois,
começou a empurrá-la. Os gritos e as agressões
pioraram, especialmente quando ele estava
bêbedo. Yulia tinha medo por si e pela sua filha,
mas não fazia ideia do que poderia fazer.



Kur Yulias më në fund iu desh të shkonte në urgjencën e spitalit me një krah të thyer, ata i thanë se dhuna në familje ishte një problem shumë i madh në Portugali. Ata gjithashtu i thanë se ishte krim dhe se ajo duhej ta raportonte në polici.

...

Finalmente, quando Yulia teve de ir para as urgências do hospital com o braço partido, disseram-lhe que a violência doméstica era um enorme problema em Portugal. Disseram também que era um crime e que ela devia denunciá-lo à polícia.



Yulia ishte e rraskapitur dhe nuk donte që vajza e saj e vogël të rritej në një shtëpi ku shikonte çdo ditë dhunë. Yulia kuptoi se shenjat e abuzimit kishin qene aty gjatë gjithë kohës, edhe pse merrnin formë të ndryshme.

...

Yulia estava exausta e não queria que a sua filhinha crescesse num lar onde assistia a violência todos os dias. Yulia apercebeu-se que os sinais de abuso tinham estado sempre presentes, mesmo que tivessem assumido muitas formas diferentes.